



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 295/1 Prot.

Tiranë, më 15/04/2015

V E N D I M

“ Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 28, datë 15/04/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Qendra “Res Publica” ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën Nr. 295 Prot., datë 09.04.2015, ndaj Klubit të Futbollit Tirana, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit*”. Ankuesi/ Qendra “Res Publica” në cilësinë e kërkuetit, me shkresën nr.034/15Prot., datë 04.03.2015, i ka kërkuar Klubit të Futbollit Tirana informacion lidhur me gjendjen financiare të Klubit të Futbollit Tirana si dhe nëse ka prapambetje në pagesat e sportistëve. Lidhur me këtë kërkesë, Qendra “Res Publica” nuk ka marrë përgjigje.

Zyra e Komisionerit, në përputhje me pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, paraprakisht ka verifikuar ekstraktin historik të shoqërisë tregtare, Klubi i Futbollit Tirana, për të përcaktuar nëse në kuptim të nenit 2 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” konsiderohet ose jo Autoritet Publik.

Pas vlerësimit u konstatua se, shoqëria tregtare Klubi i Futbollit Tirana nuk është autoritet publik për shkak se në rastin konkret njësi e qeverisjes vendore Bashkia Tiranë, zotëron vetëm 34% të aksioneve dhe jo shumicën e tyre, referuar përkufizimit të nenit 2, pika 1, gërma i) e për rrjedhim nuk i nënshtrohet detyrimeve të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, ankesa e Qendrës “Res Publica”, rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 295 Prot., datë 09.04.2015 të Qendrës “Res Publica”, ndaj Klubi i Futbollit Tirana
2. Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot në datë 15.04.2015.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI

